

04.02.2022
Ora 14:35

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, V.Ballgjini

Parti Politike: LSI (A.Kaziaj)

OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 4 shkurt 2022. Njoftimi për mbledhjen është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu njoftimi bashkë me materialet e mbledhjes u janë komunikuar dhe partive politike, të regjistruara tashmë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si subjekte zgjedhore. Në rendin e ditës kemi një projektvendim për ta shqyrtuar, një projektvendim shumë të rëndësishëm, siç është ai “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

organet e qeverisjes vendore”. Shqyrtimi i këtij projektvendimi vjen pasi Komisioni Rregullator disa ditë më parë, më datë 29 janar 2022, ka miratuar me vendimin nr. 9, rregullat për raportimin financiar të partive politike dhe subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Projektvendimi ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kështu që, në këtë mbledhje do ta prezantojë aktin Sekretari i Përgjithshëm. Të pranishëm përveç Sekretarit të Përgjithshëm dhe zyrtarëve të tjerë të administratës së KQZ-së është dhe përfaqësuesi i subjektit zgjedhor, Lëvizja Socialiste për Integrim, apo i ndonjë subjekti tjetër, zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i “Shtëpisë së Lirisë”: Po, e nderuar zonja Kryetare, faleminderit! Para se kjo mbledhje të bëhej, ishte mbledhja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili pranoi kërkesën tonë për regjistrim si koalicion zgjedhor, nga tani e tutje jam dhe përfaqësuesi i “Shtëpisë së Lirisë”, komisionit zgjedhor të regjistruar.

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, zoti Merkaj, ju lutem prezantimin e projektvendimit!

Z. Y. Merkaj: Neni 20, pika 1, shkronja “gj” e Kodit Zgjedhor ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator, për miratimin e projektakteve me karakter normativ për udhëzimin dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjektet zgjedhore dhe zgjedhësve. Referuar nenit të mësipërm është hartuar dhe projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve, për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e një përmbledhjeje të bazës ligjore të kërkesave që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore, për partitë politike, subjektet zgjedhore, kandidatët për kryetarë

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*


bashkie, kandidatët e listave shumëemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Si dhe jep udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularëve tip të raportimit financiar të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët nga lista shumëemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Projektvendimi nëpërmjet shembujve konkretë pasqyron mënyrën e saktë të plotësimit të formularëve tip të raportimit të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe afatet e dorëzimit. Këta udhëzues synojnë të shpjegojnë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojnë partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumëemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, për mënyrën e plotësimit të raporteve financiare të fushatës zgjedhore, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në funksion të këtij qëllimi janë përgatitur 4 projektudhëzime dhe përkatësisht:

- udhëzimi për raportimin e partive politike;
- udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatë për kryetar bashkie;
- udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e listave shumëemërore;
- udhëzues për mënyrën e raportimit financiar të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Udhëzuesit janë ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë, paraqet një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, ku përfshihen përkufizimet dhe shembuj konkret të raportimit financiar, në formatet standarde të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

Pjesa e dytë ofron udhëzime për mënyrën e plotësimit të formateve të raportimit financiar, ku shpjegohet regjistrimi i veprimeve financiare në formatet e standartizuara dhe mënyrën e duhur të raportimit të tyre.

Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë dhe shpjegimet e nevojshme që kanë të bëjnë me seksionet kryesore të formatit tip të raportimit.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe udhëzuesit, ose projektudhëzuesit që shpjeguam më lart, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Me këtë rast gjej vendin të falënderoj administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për përgatitjen e këtij akti shumë voluminoz dhe shumë të detajuar. Bëhet fjalë ky falenderim për të gjithë aktet që vijnë dhe për punën tuaj në këtë periudhë kaq të ngjeshur me afate dhe me veprimtari. Atëherë kolegë, kalojmë në shqyrtimin në parim të projektvendimit. Dëshiron dikush të marrë fjalën? Qoftë anëtarët e Komisionit Rregullator, qoftë përfaqësues të subjekteve zgjedhore. Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit zonja Nano! Unë e dëgjova me vëmendje prezantimin që bëri Sekretari i Përgjithshëm të këtij projektakti. Në fakt, ne kemi miratuar dhe një akt në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 Prill 2021. Pra, udhëzuesit për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme. Në rastin konkret si dhe në raport me projektaktin që kemi miratuar, do të doja konkretisht nga drejtoresha e auditit të kishim një opinion nëse ka ndryshime, shtesa, ose më saktë, çfarë risish paraqet ky projektakt në raport me aktin e miratuar më parë të Komisionit Rregullator.

Znj. I. Nano: Po, zonja Ballgjini!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

Znj. V. Ballgjini: Po, në fakt edhe siç ju e përmendët, në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 është miratuar një vendim i kësaj natyre, ku janë parashikuar udhëzues dhe raporte financiare, modelet e raporteve financiare që duhet të dorëzojnë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje. Detyrimin për zgjedhjet për Kuvend e kanë pasur partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Në projektaktin e vënë në dispozicion nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar, për organet e qeverisjes vendore. Parashikohet përveçse partive politike, kandidatëve të listave shumëemërore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, janë dhe kandidatët për kryetar bashkie, dhe në një nga detyrat që i shtohet kandidatit për kryetar bashkie është edhe plotësimi i pasqyrave financiare dhe parashikimi i shpenzimeve për mitingje. Kjo është një përmbledhje e shkurtër në lidhje me çfarë kemi miratuar për zgjedhjet e datës 25 prill dhe çfarë pritet të miratojmë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, faleminderit!

Z. M. Çakaj: Faleminderit!

Znj. I. Nano: Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Vërtet akti i ardhur, pra projektakti, të cilin presim ta miratojmë, është një akt voluminoz. Vjen në përmbushje të një detyrimi shumë serioz për partitë politike, pra subjektet zgjedhore në funksion të transparencës dhe bërjes publike në mënyrë objektive të parasë publike të përfituar, e në këtë kuadër, meqenëse ky akt vjen si, le të themi, si konsekuencë, ose si vijim i aktit që ne miratuam më herët, e meqenëse aty ne rritëm standardin dhe si të thuash, rritëm profilin e verifikimit, apo të auditimit duke e çuar drejt standardeve

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

ndërkombëtare. Do të kërkoja meqenëse akti është kaq voluminoz dhe mos të binim në përsëritje apo t'i konsideronim propozime konkrete, do të kërkoja nga administrata që në zbardhjen përfundimtare të këtij akti, në hapësirat dedikuar transparencës dhe mënyrës së raportimit, të implementonte standardet ndërkombëtare të auditimit, dhe standardet kombëtare të kontabilitetit. Bashkë me drejtoreshën kemi diskutuar që standardet *ISSAI* përfshihen nga numri 701-799, apo thënë ndryshe standardet ndërkombëtare të auditimit. Kështu që, drejtoresha si profesioniste e fushës e njeh mirë këtë proces dhe shpresoj në implementimin hap pas hapi, apo hapësirë pas hapësire të këtyre standardeve, me qëllim që të rritet kualiteti dhe në të njëjtën kohë publiku të ketë më transparente pasqyrat që do të sjellin ato që ligji u ngarkon me këtë detyrim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Kolegë, besoj që ky propozim i zonjës Vukaj, ose sugjerim është nën vijim të atyre që u diskutuan edhe në mbledhjen ku ne kemi miratimin e vendimit nr. 9. Kështu që nuk po e konsideroj si propozim për ndonjë shtesë apo ndryshim, por për mënyrën e reflektimit aty ku duhet dhe ku është e mundur të të gjithë këtyre sugjerimeve konstruktive, për ta rritur cilësinë e aktit dhe për ta përshtatur edhe me nivelet ndërkombëtare të auditimit. Ajo ç'ka duhet të theksoj përpara se të kaloj në votimin në parim të aktit, nëse nuk do të kenë gjë dhe kolegët e tjerë, është që ky projektakt nuk lidhet ngushtësisht me zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Zgjedhje, të cilat janë vetëm për kryetar bashkie në 6 bashkitë, sipas dekretit të Presidentit të Republikës, por është një akt i cili i shtrin efektet dhe veprimin e vet për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Kjo do të thotë, edhe në zgjedhjet e radhës, ku do të kemi zgjedhje si për kryetar bashkie ashtu edhe për këshillat bashkiakë. Ka diçka dikush tjetër për të shtuar, lidhur me diskutimin në parim?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. A. Kaziaj, përfaqësues i “Shtëpisë së Lirisë”: Vetëm t’i bashkohesha falenderimit tuaj që thatë në fjalën hyrëse, përsa i përket pjesës së stafit. Gjithë stafit administrativ të KQZ-së, të cilët kanë punuar në mënyrë të palodhur, qoftë dhe për volumin e vetë akteve që ju miratoni. Kështu që, faleminderit atyre që në kohë, në afate dhe me shumë profesionalizëm që zgjedhin këto akte dhe propozojnë juve për të miratuar aktet e kësaj natyre, të cilat rregullojnë në vetvete atë që është fushatë zgjedhore.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Atëherë kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kolegë, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka


Me 5 vota pro, miratohet në parim!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Në fakt, ky vendim ka 3 pika.

Pika e parë është miratimi i udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike kur konkurrojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si vijon:

- a. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, koalicionet sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- b. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët për kryetar bashkie sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- c. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumemërore sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- d. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e pavarur sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

Fillojmë shqyrtimin e nenit 1. Në fakt, neni 1 është ky që lexova, por ndërkohë janë 4 shtojcat, të cilat siç thamë janë voluminoze dhe nuk mund t'i lexojmë këtu. Ajo çka unë dua të theksoj në vijim të shqyrtimit të nenit 1 është fakti që këto 4 shtojca lidhen me këto subjekte zgjedhore, qoftë parti apo koalicion, dhe kemi kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemerore, duke patur parasysh që këta mund të jenë kandidatë të partive apo koalicioneve dhe udhëzues i veçantë, pasi kemi vendosur më herët raportimin e veçantë, për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Ndoshta jo propozim, por një korrigjim i vogël. Në pikën “d”, thuhet “udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e pavarur”, shprehja korrekte e ligjit është “kandidatët e propozuar nga zgjedhësit”. Kështu që, në qoftë se dhe kolegët janë dakord, jo në formën e një propozimi, por në formën e një korrigjimi gjatë zbardhjes. Atëherë kolegë kemi diçka për nenin 1, zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i “Shtëpisë së Lirisë”: Jo e nderuar, nuk kemi gjë!

Znj. I. Nano: Në rregull! Kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.04.02.2022*

Dhe pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kolojmë në votimin në tërësi. Edhe njëherë kolegë dakordësinë tuaj për projektvendimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Atëherë pas miratimit të këtij projektvendimi do të doja, qoftë për ta bërë publike, por qoftë dhe për t'i bërë thirrje administratës. Pas miratimit të këtij akti, tashmë që kemi subjekte zgjedhore të regjistruara dhe pas miratimit të dokumenteve të kandidimit. Pra, kur të kemi kandidatët konkretë, me emra për kryetar bashkie në këto 6 bashki. Besoj, do të doja ta theksoja, nevojën e trajnimit, qoftë të financierëve të partive, por qoftë dhe të vetë kandidatëve. Pasi kanë detyrimin e tyre personal, për të bërë raportimin bazuar në këto udhëzues. Nëse mundet edhe njëherë administrata lidhur me këtë detyrim të rëndësishëm?! Mund të na thotë diçka, para se ta mbyllim mbledhjen?

Znj. V. Ballgini: Po, referuar dhe asaj që ju thatë zonja Kryetare, në miratimin e akteve për fushatën zgjedhore të datës 25 Prill 2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka qenë e angazhuar për trajnimin, apo bërjen me dije të financierëve të partive politike, për detyrimet që i lindnin nga vendimet e marra në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Sigurisht ky detyrim,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



tani më është dhe për procesin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. për këto 6 bashki momentalisht. Ne kemi përgatitur një trajnim që mendohet pasi të përfundojë i gjithë procesi, të kemi konsultime me financierët e partive, përfshirë edhe kandidatët të propozuar nga partitë, apo në qoftë se ka dhe kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Faleminderit dhe juve për sugjerimin.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zonja Vukaj, kishit dhe ju diçka?

Znj. H. Vukaj: Jo në lidhje me aktin e sotëm, e nderuar, pasi u miratua dhe konsiderojmë që ka përmbushur gjithë rregullsinë. Por, në lidhje si për vijim dhe përforcim i zbatimit të aktit, që ne miratuam më herët, “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë operatorët e pajisjeve të identifikimit elektronik, të votuesve në qendrën e votimit dhe të procedurave të rekrutimit”. Ky është një akt i rëndësishëm, absolutisht, por që është në momentin kulminant të zbatimit dhe verifikimit të kandidaturave nga ana e administratës. Një sugjerim apo një vëmendje për administratën, meqenëse vija e demarkacionit mes papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit ishte kaq e ngushtë sa që ne gjetëm një *intermezzo* për të dakordësuar. Do të kërkoja që në funksion të efikasitetit dhe efencës, por edhe të moskonsumimit të ripërsëritjeve administrative, të disa formaliteteve mbi kandidaturat. Do të doja që të zbardheshin emrat e individëve që punojnë si punonjës aktualë, pranë firmave të nënkontraktuara nga KQZ-ja, në lidhje me pajisjet apo me gjithë inovacionin e implementuar si risi në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021. Kjo do të lehtësonte administratën për të pasur një transparencë dhe prezentë këta emra, të cilët do t’i mundësonin nga ana tjetër moskualifikimin e drejtpërdrejtë të tyre, pasi do të binte ndesh me çfarë ne përcaktuam. Ky ishte një sugjerim, këshillë ose një...

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. Y. Merkaj: Do të kontaktojmë me kompaninë dhe do t'i marrim emrat.

Znj. H. Vukaj: Në rregull, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit kolegë. Duke qenë që nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të diskutuar. Projektvendimin e miratuam, lutem zbardhjen sa më të shpejtë dhe publikimin e projektvendimit. Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr.13

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

